

**Data 27.09.2022**

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROKURIMIT: .**

“Furnizim dhe vendosje matsash uji në pallatet me kollonë të brendëshme, qyteti Tepelenë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) Punime ndërtimi për qëllime të ndryshme 45262600-7; pune muratimi 4526252522-6; sahate

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

12.769.562 (dymbëdhjetë milionë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy ) leke pa tvsh;.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Tepelenë\_ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. formularin e ofertës , sipas shtojcës 1
- b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës .3;
- c. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8
- ç. Lista e çmimeve sipas artikujve sipas shtojcës 2

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

---

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" si dhe nenit

(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit apo nevojën që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës).*

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

**2.2.1.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. 2019,2020,2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% te vleres se parashikuar te kontrates.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43,pika 2 c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin 9920 datë 19.05.2008 ,për "Procedurës Tatimore "neni 64 Deklarata Tatimore.*

(Shënim: *citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).*

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2019,2020,2021 të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi nuk ka raport negativ ndëmrjet pasivit dhe aktivit, ose tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël."

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njësive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin 2022 sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar.

\* Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia.

Bazuar në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore i ndryshuar

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 45% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
  - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 100 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:

- Formular vlerësimi (Shtojca 9)
- Situacion përfundimtar të objektit,

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Situacionin përfundimtar të objektit;
- Fatura tatimore
- Vërtetim për kryerjen me sukses të kontratës

*(Shënim: të përcaktohen dokumentet konkrete që kërkohen për të dëshmuar përvojën e mëparshme të ngjashme me sektorin privat, të cilat janë të nevojshme dhe i shërbejnë AK për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.)*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39 pika 5, 40 dhe 41 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 45 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose sa vlera e fondit limit, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga *Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit*, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

1. NP 1 - A (Punime gjurmimi në tokë)
2. NP 2 - A (Ndërtime civile industriale)
3. NS 1 - A (Punime për prishjen e ndërtimeve)

*\*Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zerave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit të merr për shprehje të realizojë).

*(Shënim: përcaktoni kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për

*licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit Nr. 943, datë 28.12.2016 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të këshillit të ministrave, "për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim" (shënim: përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor që parashikon licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit, kategoritë e nevojshme të licencës, me emërtimin e tyre në përputhje me legjislacionin e fushës, duke përcaktuar edhe nivelin minimal të klasifikimit për çdo kategori, sipas vlerave të punimeve konkrete që do kryhen, si dhe institucionin që lëshon këtë licencë).*

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP 1 – A NP 2 - A NS 1 – A	Lidhje me kolektor TIP 1 ( 8 dalje)	Germime , prishje suavtime;tuba e rakordei ujesjellesi		2385649
NP 1 – A NP 2 - A NS 1 – A	Lidhje me kolektor TIP 2 ( 10 dalje)	Germime , prishje suavtime;tuba e rakordei ujesjellesi		2515226
NP 1 – A NP 2 - A NS 1 – A	Lidhje me kolektor TIP3 ( 14 dalje)	Germime , prishje suavtime;tuba e rakordei ujesjellesi		513114
NP 1 – A NP 2 - A NS 1 – A	Lidhje me kolektor TIP 4 ( 20 dalje)	Germime , prishje suavtime;tuba e rakordei ujesjellesi		1468363
NP 1 – A NP 2 - A NS 1 – A	Mtesa dhe tuva PVC per kollonen	Germime , prishje suavtime;tuba e rakordei ujesjellesi		5279137

**2.3.3.** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi.
- b. Inxhinier Hidroteknik

Drejtuuesi teknik duhet te jete **Inxhinier Ndertimi** shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratë pune e firmosur perpara noterit (e vlefshme)
2. Diplomë

3. Drejtuesi teknik duhet te figuroje i regjistruar ne listepagesa per 3 muajt e fundit.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Drejtuesin teknik per punimet).*

**2.3.4.** Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** i punësuar në shoqëri ose me kontratë , si më poshtë:

- a. Auditues energjetik (1) i certifikuar nga agjensia per eficensen e energjise ne ndertesa

**Argumentimi:** Për kriteret e përcaktuara në pikën 2.3.3. dhe 2.3.4 Njësia e Prokurimit është bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, "Për Prokurimin Publik" datë 23.12.2020, pika 4 si dhe në VKM nr 285 datë 19.05.2021 "për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" neni 39 pika 6 c. gjithashtu audituesi energjetik eshte shume u i rendesishem per kete prokurim sepse : 1. Nderhyrja do te jete drejtperdrejte ne banesa te qytetareve te bashkise tepelene; dhe demtimi që do vije nga kjo nderhyrje duhet te auditohet dhe te certifikohet .

2. permiresimi do te kryhet prej operatorit fitues

3. Bashkia Tepelene eshte pjese e projektit pilot per rinovim te godinave ekzistuese të banimit shume familjare me eficence te larte te energjise , te MIE, Agjesise per eficence te energjise.

**2.3.5** Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikata ISO te vlefshme:

1. ISO 9001- 2015 (Sistemi i menaxhimit te cilesise).
2. ISO 14001-2015 (Sistemi i menaxhimit te mjedisit).
3. OHSAS 18001-2007(Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune).  
OSE  
ISO 45001-2018 (Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë)
4. PASS 99:2012 (Sistem i integruar i menaxhimit).

*Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH".*

*Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO te kerkuar ne gjuhen shqipe.*

*Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë" , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kriteve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat Iso :*

**2.3.6.** Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/tëkualifikuar**, si më poshtë:

- **Hidraulik (3)**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);  
ose  
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik

Bazuar në zerat e punimeve sipas preventivit punime betoni, ndërtim mur guri, suvatime, kërkohet që operarori ekonomik të disponojë 3 Hidraulikë të cilët do të realizojnë këto punime.

- **Karpentier (1); Murator (1); Bojaxhi (1); Saldator (1)**

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

1. kontrata e punës e vlefshme;
2. Çertifikate për sigurimin teknik të punonjesve (e vlefshme);  
ose  
Dëshmi kualifikimi e sigurimit teknik leshuar nga

- Bazuar në preventivin e punimeve ku përcaktohet zeri i punimeve kërkohet që operarori ekonomik të disponojë Karpentier (1); Murator (1); Bojaxhi (1) Saldator (1) që do bëjë punimet.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Përprokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

**2.3.7** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 20 persona**, për periudhën korrik 2022- gusht 2022. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjesve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Ndërsa operatori fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet të dorëzojë dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nga sigurimet shoqërore ose administrata tatimore sipas formatit të legjislacionit në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjesve për periudhën kohore të kërkuar.
- Listpagesat e punonjesve për periudhën e kërkuar.

*Kriteret e percaktuara në pikën 2.3.7. Eshtë kërkuar që operatori ekonomik të ketë një staf prej 20 punonjësve për të realizuar punimet, nga zërthimi i preventivit të punimeve me manualin e miratuar me Vendimin Nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".*

- Nga zërthimi i preventivit orët e punës për çdo punim rezultojnë 1694.
- Orët në total i pjestojmë me 8 orë pune ditore  $3388 : 8 = 212$   
kemi 212 punëtorë për një ditë pune
- 212 punëtorë për një ditë punë pjestuar më 22 ditë pune mujore kemi 9.8 punëtorë për një muaj punë. Dhe për dy muaj sipas grafikut  $9.8 \times 2 = 19.6$  punëtorë për dy muaj punë.

2.3.8. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
1. Kamion me vinç	1 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>
2. Kamion 1,5-3 ton	2 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>
3. Minifadromë	1 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>
4. Aparat ngjitës tubo elektrofuzive	3 copë	<i>Pronësi ose me qera</i>

**2.3.9** Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga administratori i shoqërisë ofertuese.

**2.3.10** Makineritë e mësipërme nuk duhet të jene te angazhuara në kontrata të tjera . (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi).

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**1. Kamion me vinç** Bazuar në zërat e preventivit të punimeve “Iartësisë në të cilën do të kryhen punimet prishje suvatimi mbi mure, prishje mure tulle, prishje pllaka.

**2.Kamion 1-5- 3, Ton 2 copë** Për lëvizjen e materialeve të ndërtimit dherave kërkohet që operatori ekonomik të disponojë mjet kamionë.

**3.Mini fadromë 1copë** Për realizimin e zërave të punimeve germime kanale toke e forte janë kërkuar 1 mini fadromë.

5. Aparat ngjites tubo, elektro fuziv 3 copë Per realizimin e zerave te punimeve fv tuba rakorderi ujesjelles , lidhje me rrjetin ekzistues

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Njesia e prokurimit